

„Ju jeni e ardhmja e Kosovës!“

Përvjetori i vënies së gurthemelit të gjimnazit „Loyola“



Nxënëset me këndimin e tyre e shoqëruan ceremoninë

[Foto: m&m]

Pas një pune ndërtimore dyvjeçare ky gjimnaz tashmë përfundimisht u krye. Mjaft arsye për ta kremtuar bujshëm këtë datëlindje me personalitetet e politikës, religjionit, ushtrisë dhe shoqërisë.

Gjatë pjesës zyrtare të kremtes asnjë folës nuk e la pa e theksuar se ky gjimnaz paraqet një mundësi të veçantë për fëmijët e Kosovës. Meqë nga këtu nxënësve iu ofrohet një mundësi për ta filluar një studim në çdo vend të botës. Një folës u shpreh qartazi lidhur me rëndësinë e kësaj ngjarje. „Themeli i gjimnazit është njëkohësisht edhe themeli i një shkence frytdhënëse në Kosovë“. Shkenca me këtë është njëra prej parakushteve themelore për një bazë demokratike, shoqërore dhe solide. Mu për këtë, falënderimi i takon donatorit zemërmirë, pa të cilin edhe nuk do të kishte qenë i mundur një projekt aq i madh. Komandanti i KFOR-it, gjeneral lejtant Roland Kater, që gjithashtu ishte i pranishëm, në fjali-

min e tij, nxënësve të gjimnazit „Loyola“ iu drejtua në mënyrë të drejtpërdrejtë: „Ju jeni e ardhmja e Kosovës!“

Kosova dhe Bashkësia Ndërkombëtare dora-dorës

Fëmijë nga të gjitha etnitetet dhe drejtimet fetare mësojnë në këtë shkollë. Shqiptarë e serbë, boshnjakë e romë, muslimanë, të krishterë katolikë dhe ortodoks, këtu të gjithë i ndajnë së bashku bankat shkollore. Bashkërisht shkojnë rrugës së arsimit drejt ardhmërisë së Kosovës. „KFOR-i është i pranishëm për të gjithë njerëzit e Kosovës“, premtoi gjenerali Roland Kater, „dhe vazhdon të kujdeset për sigurinë dhe stabilitetin në Kosovë, veçanërisht gjatë fazës kalimtare!“ Arsye për t’u brengosur nuk duhet të ketë madje askush. Të gjithë folësit e theksuan që gjendja e sigurisë është e qetë, dhe që askush, që dëshi-

ron të nxisë dhunë në Kosovë, nuk do të tolerohet. „Kosova tashmë ka arritur shumë“, i gëzohet kësaj Joahim Ryker, shefi i UNMIK-ut. Ai është më se i bindur që shumica e sukseve janë arritur falë angazhimit të shkëlqyeshëm të Bashkësisë Ndërkombëtare, por para së gjithash edhe falë vullnetit të popullatës.

Ngjitja mbi arka për të guximshmit

Natyrisht që në një ngjarje të tillë nuk duhej vetëm të flitej. Me muzikën dhe me tingujt e tyre harmonikë nxënësit e shumtë të gjimnazit „Loyola“ e mbështetën këtë ceremoni. Për të gjithë ishte përgatitur diçka. Ushtarët e KFOR-it të kampionit fushor të Prizrenit, përreth pjesës zyrtare, përgatitën lojëra të mrekullueshme për nxënësit. Kështu që, fëmijët patën mundësinë që vinçin e lartë disa metërsh ta drejtojnë vetë dhe gjatë kësaj të përpiqen t’i stivojnë dy kullëza drejtimi mbi njëra-tjetrën. Natyrisht që këta u përkrahën fuqishëm nga personeli profesional. Në një vend më tutje parashihej që të stivoheshin sa më shumë arka të pijeve mbi njëra-tjetrën dhe atë duke qëndruar mbi arkën më të lartë. Nxënësit ishin të siguar nga një litar i gjatë që varej në një vinç tjetër. Të guximshmit arritën kështu një lartësi prej tetë ose nëntë arkave. Madje edhe për të vegjëlit kishte diçka të veçantë: sipas dëshirës ata mund ta ngjyrosnin me bojëra vetveten. Në këtë mënyrë, ceremonia e gjimnazit „Loyola“ u bë një festë, e cili ofroi për secilin diçka. Dhe, për fëmijët dhe të rinjtë e Kosovës do të ofrojë një hap të madh drejt ardhmërisë.

(m&m)



Komandanti i KFOR-it, gjenerali Kater: „Fëmijët janë e ardhmja jonë!“

[Foto: m&m]